



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.1363/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë ne Prishtinë, me gjyqtarin Dren Rogova, në çështjen përmbarimore të kreditorit Kompania Ujësjiellësi Rajonal “Prishtina sh.a me seli ne Prishtinë, rr. Hazir Shala 4, ndaj debitorit “Euromed Group” shpk, me seli ne rr. “Nëne Tereza” nr.158 ne Fushë Kosovë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1315/2022, të datës 21.07.2023, me datë 15.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e themeltë ankesa e kreditorit Kompania Ujësjiellësi Rajonal “Prishtina” sh.a me seli ne Prishtinë, rr. Hazir Shala 4, PRISHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1315/2022, të datës 21.07.2023, dhe çështja i kthehet Gjykatës Komerciale – Dhomave të Shkallës së Parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1315/2022, të datës 21.07.2022, e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit “Euromed Group” shpk, me seli ne rr. “Nëne Tereza” nr.158 ne Fushë Kosovë ndërsa e ka shfuqizuar urdhrin përmbarimor P.nr.78/2021 dt.25.01.2021 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Bardh Tasholli ,me seli ne Ferizaj.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike, shkeljes esenciale te dispozitave te procedurës civile dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që Gjykata e shkalles se dytë, ta aprovoj ankesën e debitorit si të bazuar, ta refuzoj prapësimin e debitorit, ta anuloj aktvendimin e atakuar dhe çështjen ta kthej ne shkallë te parë ne rivendosje.

Dhoma e shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Ujësjetllësi Rajonal "Prishtina" sh.a me seli ne Prishtinë, rr. Hazir Shala 4, me datë 25.01.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit "Euromed Group" shpk, me seli ne rr."Nënë Tereza" nr.158 ne Fushë Kosovë, në bazë të dokumentit të besueshëm-Ekstraktit nga librat e kontabilitetit me shifrën 3475. Përmbartuesi Privat Bardh Tasholli nga Ferizaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lejuar përmbartimin me urdhrin përmbartimor P.nr.78/21 dt.25.01.2021, me të cilën ka detyruar debitorin që kreditorit në emër të borxhit për shërbimet publike-furnizim me ujë te pijshëm, t'ia paguajë shumën prej 5,298.22 euro dhe atë ne afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit te urdhrin përmbartimor si edhe shpenzimet e përmbartimit.

Ndaj këtij urdhri përmbartimor me datën 02.02.2021, ka ushtruar prapësim debitori, me arsyetimin se Poliklinika Euromed është themeluar ne vitin 2017 dhe nuk ka ekzistuar me herët ndërsa borxhin kreditori ua ka referuar Euromed Group, shton se klinika Euromed është vendosur ne një ndërtesë, ku një pjesë e ndërtesës është Spital ndërsa pjesa tjetër është e banuar nga njerëzit, ndërsa kreditori te gjithë borxhin e këtij kompleksi ua faturon Spitalit Euromed sepse ora ka qenë e përbashkët, arsyeton se tere borxhi duhet te ndahet dhe ne do ta kryejmë pagesën qe na takon dhe jo këtë borxh i cili na është vendosur paushall. Deklaron se ne bazë te gjendjes prej momentit qe është bërë ndarja e orës vlere e faturave te cilat kane ardhë ka qene 14 euro, 28 euro, 39 euro etj, ashtu qe borxhi qe kërkon kreditori është i papranueshëm dhe si te tillë nuk do ta paguajmë deri sa te sqarohet ky problem.

Ndaj prapësimin te debitorit me datën 04.02.2021, ka ushtruar përgjigje kreditori, duke arsyetuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit sepse i njëjti ka qenë i njoftuar për gjendjen reale te tij dhe se lokali ku debitori e shfrytëzon për veprimtarinë e tij është ne rregull dhe ne bazë te konsumit te regjistruar ne ujëmatës dhe koform kategorisë se debitorit Euromed Group shpk nga Fushë Kosova. Andaj e kundërshtoni deklarimin e debitorit dhe kërkon nga gjykata qe te hedh poshtë prapësimin e te njëjtit ashtu qe te obligohet debitori te kryej detyrimin e tij.

Gjykata Komerciale e Kosovë – Dhomat e shkallës së dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par. 2, pika n) të LPK, për arsye se aktvendimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet. Sipas vlerësimit të Dhomave të Shkallës së Dytë, qëndron fakti se me dispozitat e Nenit 38 të LPP-së janë përcaktuar kushtet ligjore për përbajtjen e propozimit për përmbarim. Po ashtu është evidente se propozimi për përmbarim duhet të përmbajë të dhënat personale, respektivisht numrin e regjistrimit të biznesit, mungesa e të cilave është kusht për të cilat përmbaruesi privat do të duhej të kujdesej sipas Nenit 38 par.2 të LPP-së lidhur me Nenin 102 të LPK-së. Megjithatë, në rastin konkret pavarësisht se propozimi përmban të dhëna të kufizuara të subjektit afarist si palë debitorë, i njëjti me rastin e prapësimit, konteston faktin se njehsori ka qenë për tërë ndërtesën – gjë që nuk është rrethanë faktike ëpr të cilën gjykata mund të ndryshojë gjendjen. Në një gjendje të tillë të çështjes, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes ka vepruar me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, pasi që me rastin e shqyrtimit të rregullsisë së propozimit gabimisht është trajtuar çështja e legjitimitetit të palës debitorë si çështje që i takon natyrës materialo-juridike. Në këtë drejtim, propozuesi ka iniciuar përmbarimin ndaj Euromed Group SHPK, sic është edhe kartela financiare, ndërkaq prapësimi është bërë nga ana e Klinikës Euromed. Në këtë drejtim gjykata, fare nuk ka shqyrtuar subjektivitetin preoedural të palës që ka ushtruar prapësimin, por ka vlerësuar legjitimitetin pa pasur prapësim nga vet subjekti në procedurë Euromed Group ShPK.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, nuk mund ta pranoj qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, se një kusht i tillë i numrit të bizensit në kartelën e konsumatorit është pengesë e cila ndikon në shfuqizimin e urdhrit për përmbarim. Sepse, fakti se si debitor nuk është paraqitur vet debitori Euromed Group SHPK, gjykata do të duhej të shqyrtojë juridiksionin për të vepruar sipas prapësimit të një pale e cila në propozuim nuk evidentohet si debitorë.

Duke iu referuar shkresave të lëndës, prapësimit si dhe pretendimeve ankimore, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka vlerësuar se propozimi për përmbarim duhet të shfuqizohet. Dhomat e Shkallës së Dytë kanë vlerësuar propozimin për përmbarim dhe dokumentin e besueshëm – ekstraktin nga librat afarist të kreditorit dhe vlerësojnë se debitori është përcaktuar në propozim, ndërkaq ekstrakti i plotëson të gjitha kushtet ligjore nga Neni 29 par.3 i LPP-së.

Në rivendosje, dhomat e shkallës së parë duhet të vlerësojnë kushtet ligjore për lejimin e përmbarimit duke vlerësuar dokumentin përmbarimor – ekstraktin nga librat afarist se a i plotëson kushtet ligjore për të qenë i përmbarueshëm, si dhe nga të dhënat e evidentuara në këtë dokument a mund të vërtetohet gjendja faktike sic pretendon propozuesi në propozimin për përmbarim, duke shqyrtuar pretendimet e palës debitorë lidhur me parashkrimin.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1, pika (d) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
Kom.Dh.Shk.II.nr.1363/2023 me datë 15.03.2024

Gjyqtari,  
Dren Rogova